

I nderuar Z. Ambasador I Delegacionit të Komisionit European,

I nderuar Zj. Ambasadore e Mbretërisë së Bashkuar,

I nderuar Z. Ambasador i Republikës së Italisë,

I nderuar Z. Ambasador i Republikës së Hungarisë,

I nderuar Z. Zëvendës Ministër i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës,

Të nderuar pjesëmarrës,

Është një kënaqësi e veçantë për mua që t'ju uroj mirëseardhjen në këtë takim të organizuar për prezantimin e projektit të binjakëzimit të Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës, dhe Ndhmës Shtetërore me Autoritetin Italian të Konkurrencës, Departamentin e Inovacionit, dhe të Biznesit të Mbretërisë së Bashkuar , dhe Autoritetin Hungarez të Konkurrencës.

Objekti i këtij projekti është forcimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë, në fushën e konkurrencës dhe të ndihmës shtetërore, për të siguruar një mjedisi sa më konkurrues, si dhe të risi transparencën në zbatimin e parimeve bazë në këto fusha.

Përfituesit real të këtij investimi janë ekonomia dhe konsumatori shqiptar.

Të nderuar Pjesëmarrës,

Mirë funksionimi i tregut të brendshëm është një nga kriteret bazë të Kopenhagenit dhe një nga shtyllat e traktatit të Lisbonës, realizimi i të cilit përbën misionin kryesor të Autoriteti Shqiptar të Konkurrencës dhe të Ndhmës Shtetërore.

Në këtë kontekst, mbështetja financiare për rritjen dhe konsolidimin e kapaciteteve administrative të këtyre institucioneve përbën një faktor shumë të rëndësishëm për mbrojtjen, nxitjen dhe promovimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Konkurrenca është një kusht jetik për filozofinë e ekonomisë së orientuar drejt tregut, si dhe një faktor shumë i rëndësishëm për rritjen e vazhdueshme dhe të qëndrueshme të ekonomisë së vendit si dhe aftësisë konkurruese të saj.

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës është vlerësuar në mënyrë progresive nga mbikëqyrësit kombëtar dhe ndërkombëtar, fakt i cili, rritë besimin se ky investim do të ketë një rikthim me një normë të pëlqyeshme “interesi”, nëpërmjet mbrojtjes dhe nxitjes të një nga instrumenteve bazë të rritjes së qëndrueshme ekonomike të vendit dhe të rritjes së mirëqenies së konsumatorit shqiptar.

Mbrojtja dhe advokacia e lojës së ndershme midis lojtarëve të tregut sjell një rritje të qëndrueshme të efikasitetit të përdorimit të burimeve nga operatorët e tregut nëpërmjet investimeve në teknologjitë e reja dhe eficiente si dhe të mirëqenies konsumatore nëpërmjet ofrimit të mallrave dhe shërbimeve më cilësore, me çmime më të ulëta dhe me më shumë zgjedhje.

Autoriteti i Konkurrencës ka pasur mbështetjen e Këshillit të Ministrave dhe të Kuvendit. Megjithatë, duke qenë një institucion i ri e me përvojë të kufizuar, është akoma në fazën e konsolidimit. Ky fakt shprehet në numrin e konsiderueshëm të vendimeve të cilat kanë si objekt të tyre luftën ndaj praktikave anti-konkurruese të shfaqura në formën e marrëveshjeve të ndaluara apo të sjelljeve të koordinuara, abuzimit me pozitën dominuese, apo kontrollit të përqendrimeve. Gjithashtu, janë dhënë një numër i konsiderueshëm vendimesh për rekomandime për rritjen e konkurrencës në sektorë të ndryshëm si ai bankar, telekomunikacionet, energjisë, hidrokarburet etj. Një pjesë e madhe e këtyre rekomandimeve janë mbajtur parasysht nga qeveria shqiptare.

Pra, sot Autoriteti ka eksperiencat e veta, por mbajtja e ritmit të rritjes institucionale kërkon forcimin e kapaciteteve administrative për të zbatuar politiken dhe ligjin për mbrojtjen e konkurrencës në mënyrë të përafërt dhe me të njëjtin intensitet me praktikatat e Bashkimit Evropian. Dhe kjo mbetet një sfidë për Autoritetin e Konkurrencës.

Përfitimi nga ana e autoritetit i projektit të Binjakëzimit dhe të projektit të asistencës teknike në kuadër të programit IPA 2008, vjen në kohën e duhur për të ndihmuar në kapërcimin e kësaj sfide.

Në kuadër të këtij projekti, stafet e Autoritetit do të kenë mundësi të njihen me mënyrën se si vendet e Bashkimit Evropian e zbatojnë konkretisht politikën e konkurrencës, sfidat konkrete të zbatimit të saj, rritjen e efekteve në treg dhe mënyrën për të kapërcyer këto sfida. Për ne është veçanërisht e rëndësishme pjesëmarrja në këtë projekt i një vendi të ri anëtar si Hungaria, duke na mundësuar një pamje më të drejtpërdrejtë të problemeve konkrete që duhet të kapërcehen në procesin e integritit. Kjo përvojë e kombinuar me atë të Italisë në fushën e konkurrencës dhe Mbretërisë së Bashkuar në Fushën e ndihmës shtetërore do të sjellë një maksimizim të përfitimit të Autoritetit të Konkurrencës dhe ndihmës shtetërore nga ky projekt.

Qëllimi ynë është që jo vetëm të rrisim njohuritë teorike mbi zbatimin e politikës së konkurrencës por edhe të përfitojmë nga **know how** i krijuar nga Autoritetet italiane dhe hungareze partnere në këtë projekt.

Veçanërisht i rëndësishëm për ne do të jetë ndihmesa për të përballur me sukses sfidat që vijnë nga përshtatja sa më e plotë e legjislacionit shqiptar me atë të BE, duke pasur parasysh dinamikën e zhvillimit të tij. Një aspekt i rëndësishëm do të jetë nxitja e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës edhe në drejtim të liberalizmit e hapjes për konkurrencën në të gjithë sektorët e ekonomisë. Kjo në përputhje me legjislacionin dhe praktikën evropiane të fushës por gjithmonë duke pasur parasysh veçoritë e zhvillimit të vendit tonë.

Një veçori e vendeve si Shqipëria, që synojnë integrimin në Bashkimin Evropian, është se jo vetëm duhet të mbrohet konkurrenca me anë të mekanizmave ligjorë, por edhe duhet të promovohet ajo, si në publikun e gjerë, ashtu edhe midis aktorëve e faktorve të ndryshëm të tregut e institucioneve publike shumë prej të cilave gjenden të përfaqësuara këtu sot.

Projekti i binjakëzimit do të ndihmojë në rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit me aktorët e tregut, institucionet e ndryshme dhe pushtetin gjyqësor.

Me anë të këtij bashkëpunimi do të kemi një përmirësim të zbatimit të ligjit si në drejtim të cilësisë ashtu edhe të shpejtësisë së kryerjes së hetimeve në mënyrë që ndërhyrja e autoritetit të konkurrencës të jetë sa më efektive e në dobi të zhvillimit ekonomik të vendit.

Zonja dhe zotërinj,

Ju falënderoj edhe një herë për vëmendjen tuaj dhe veçanërisht falënderoj Ambasadorin Sekui, si përfaqësues i Komisionit Evropian për mbështetjen dhe besimin e këtij institucioni për Autoritetin e Konkurrencës.